



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

Nr 26 Prot.

Datë 18.03.2026

FTESË E HAPUR

PËR

ORGANIZIMIN E AKTIVITETIT “FESTA E BIRRËS”

QAK Bashkia Korçë shpall ftesë të hapur për organizimin e aktivitetit “Festa e Birrës”.

Përshkrimi i projektit:

Korça njihet gjerësisht si qyteti i kulturës, arsimit, serenatave, karnavaleve, etj. Ky qytet mirëpret të gjithë ata që e duan natyrën e bukur, artin, argëtimin pafund dhe traditën. “Korça qyteti i festave” një program që përmban një sërë projektesh kulturore, artistike dhe turistike e ndërthurur edhe me bukurinë natyrore dhe muzemet e shumta në qytet, e ka shndëruar Korçën në qendrën më të rëndësishme dhe më të frekuentuar turistike në Shqipëri. Festa e Birrës, një sukses i garantuar ka sjellë më shumë se 100,000 vizitorë gjatë pesë ditëve të festës, duke e kthyer atë në festën më të madhe në Shqipëri.

20 vite “Festa e Birrës në Korçë”, tashmë është etaloni matës i gjithçkaje që organizohet në vendin tonë.

Qëllimi i projektit:

Promovimi i kulturës, traditës Korçare. Nxitja e turizmit dhe rritja e numrit të turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë Korçën.

Aplikimi:

Të drejtën për të aplikuar e kanë:

- a) Çdo person fizik/juridik vendas dhe të huaj të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi dhe që ushtrojnë veprimtari artistiko – kulturore;

DOKUMENTAT QË DUHET TË DORËZOHEN NË MOMENTIN E APLIKIMIT TË PROJEKTIT.

- a) Formulari i aplikimit pjesë e kësaj rregullore;
- b) Kërkesa për mbështetje finaciare, e protokolluar në QAK;
- c) Projekti artistik - kulturor, i ndërtuar mbi bazën e të gjitha pikave të përcaktuara në formatin e Aplikimit.
- d) Vendimi i Gjykatës, Statuti i Shoqatës/Shoqërisë, Akti i themelimit, NIPT. (kopjet duhet të jenë të noterizuara.) Ekstraktet.
- e) Vërtetim nga Gjykata që Shoqata, Fondacioni, shoqëria, nuk është në proces falimentimi apo likuidimi dhe certifikatë e gjendjes gjyqësore të shoqërisë/administratorit.
- f) Numri i llogarisë Bankare në të cilin do të bëhet derdhja e fondeve të kërkuara. (IBAN -lek)
- g) Preventivi, total i detajuar në të gjithë zërat e tij, në krah të jenë shënuar donatorët përkatës.
- h) Preventivi për zërat që janë dhënë nga Bashkia. (Preventivi duhet të jetë i firmosur dhe i vulosur nga aplikuesi. Ky preventiv mbetet i diskutueshëm nga Bordi Artistik i Bashkisë Korçë).
- i) Dy rekomandime të lëshuara nga personalitete të shquara sipas fushës që mbulon projekti.
- Tre rekomandime nese subjekti aplikues është individ.
- j) Deklarata mbi të ardhurat e projektit, nëse ka, si do të përdoren këto të ardhura.

k) Fotokopje të kartës së identitetit ose pashaportës të aplikantit.

- Në rast se aplikimi bëhet nga një individ në vend të pikave d) e) zëvendësohen me një biografi personale, CV dhe të aktivitetit artistik).

l) Subjekti aplikues nuk duhet të ketë detyrime të papaguara vendore, detyrime të ngarkuara nga organet kompetente audituese apo detyrime të ngarkuara nga organe të tjera (në favor të Bashkisë Korçë). Vërtetim për detyrimet vendore dhe vërtetim për detyrimet tatimore dhe kontributet e sigurimeve shoqërore nga Drejtoria e Tatimeve.

Deklaratë në formë vetëdeklarimi se do sigurojë kapacitet financiar, material dhe burime njerëzore për organizimin e aktivitetit Festa e Birrës.

Aplikimi për organizimin e këtij projekti duhet të paraqitet në formën sipas formularit tip, bashkëngjitur kësaj ftese.

Mospërmbushja e kriterëve është shkak skualifikimi.

Nuk mund të aplikojnë:

Personat juridik publik që përfaqësojnë institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore, qendrore ose vendore, që vetëfinancohen ose financohen nga buxheti i shtetit ose nga ente të tjera publike të miratuara me ligj.

Koha e zhvillimit dhe shpalljes së fituesit:

Shpallja e Ftesës së Hapur bëhet më datë **18.03.2026**.

Data e fundit e aplikimeve **02.04.2026**.

Bordi Artistik në QAK Bashkia Korçë do të mbledhet me datën **07.04.2026**.

Shpallja e fituesit do të bëhet deri me datë **10.04.2026**.

Fituesi do të njoftohet publikisht nga QAK Bashkia Korçë.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Aplikuesit duhet të dorëzojnë projektin dhe dokumentet e tjera të kërkuara tek

Sekretari/Protokolli pranë QAK Bashkia Korçë, sipas kriterëve të përcaktuara në formularin tip bashkëngjitur kësaj ftese, i cili duhet të plotësohet në mënyrë elektronike.

Fondi limit është 12.000.000 (dymbëdhjetemilion) lek me tvsh.

KRITERET E KËRKUARA:

1. Operatori që merr përsipër realizimin e Festa të Birrës, duhet të ketë eksperiencë të njohur në zhvillimin e aktiviteteve të këtij lloji.
2. Operatori duhet të ketë në CV – në e tij arritje dhe suksese të vërtetueshme në evente të tilla të përmasave të mëdha.
3. Vlerësohet cilësia artistiko –kulturore e projektit dhe pjesëmarrja e emrave të njohur të skenës.
4. Operatori/individ duhet të ketë bashkëpunime artistike të nivelit të lartë;

KRITERET E VEÇANTA PËR OPERATORIN EKONOMIK QË DO TË ORGANIZOJË FESTËS SË BIRRËS

1. Aktiviteti “Festa e Birrës” do të zhvillohet në datat 12/08/2026 - 16/08/2026.Vendi do të përcaktohet nga Bashkia Korce ne vijim.
2. Subjekti/ individ duhet të paraqesë planvendosje për shfrytëzimin maximal të hapësirës së vënë në dispozicion nga Bashkia.
3. Festa e Birrës duhet të ketë skenë jo më pak se 20 metër linear gjatësi, 8 metër linear gjerësi dhe lartësi jo më pak se 1,8 metër nga toka.
4. Skena duhet të ketë jo më pak se 80 m² ekran Led outdoor, ku operatori ekonomik duhet të sigurojë që shfaqë grafika shoqëruese sipas programit muzikor për të 5 netët e festës.
5. Operatori duhet të sigurojë foni për të mbuluar një kapacitet jo më pak se 8000 persona, që frekuentojnë festën.
6. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër ndriçimin e skenës me robotë dhe efekte speciale shtesë si CO2 (tymuese skenike).
7. Ndriçimin e të gjithë sheshit të aktivitetit ku do të zhvillohet festa.
8. Vendosjen e 40-60 stendave shërbimi të përshtatshme për bizneset pjesëmarrëse në festë.
9. Krijimin e zonës me rezervimin, e cila duhet të funksionojë online dhe fizikisht në ambientet e festës.
10. Sigurimin e jo më pak se 300 sete tavolina dhe stola uniforme, (Cdo tavoline duhet të jete e pajisur me 2 stola), ku mund të qëndrojnë lirisht 6 persona.
11. Ruajtjen e zonës përgjatë 24 orëve gjatë 5 netëve të festës me staf të kualifikuar të kompanive të sigurisë fizike nga momenti që fillon puna për infrastrukturën e aktivitetit deri në përfundim të tij

dhe largimit të gjithë pajisjeve të infrastruktures së festës, mbulumin me fotograf profesionist, i cili duhet të realizojë video dhe foto gjatë 5 netëve të festës.

12. Krijimin e imazheve digjitale që do të promovohen gjatë festës së birrës, sigurimin e gjithë programit muzikor në të 5-ta netët e festës me jo më pak se 3 këngëtarë dhe/ ose banda muzikore për çdo natë, të cilët duhet të jenë artistë të njohur nga Shqipëria dhe rajoni.
13. Ruajtja dhe shoqërimi i këngëtarëve/ bandave muzikore , para, përgjatë dhe pas performancës së tyre, nga staf i sigurisë i kualifikuar nga kompani të ruajtjes dhe sigurisë fizike.
14. Festa e Birrës duhet të fillojë çdo ditë në orën 20:30 dhe do të vazhdojë deri në orën 1:00 pas mesnate.
15. Hyrja në Festën e Birrës do të jetë e lirë (pa pages) në të 5 -ta netët e aktivitetit.
16. Subjekti duhet të koordinojë gjatë gjithë kohës punën me Qendrën e Artit dhe Kulturës dhe Sektorin e Turizmit të Bashkisë Korçë.
17. Logoja e Bashkisë Korçë duhet të jetë logoja qendrore e festës dhe nuk duhet të mungojë në asnjë postim para, gjatë dhe pas festës.
18. Operatori ekonomik duhet të sigurojë transportin me mjetet e tij të të gjitha materialeve/ pajisjeve teknike të sipërpërmendura.
19. Bashkia Korçë mundëson vendin e organizimit të festës, sigurimin me energji elektrike, ujë dhe staf ndihmës nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (NSHP), për pastrimin e zonës, asistencë në lidhjen e energjisë elektrike dhe shërbimeve ndihmëse gjatë ditëve të zhvillimit të aktivitetit, si edhe vendosjen në dispozicion të Policisë Bashkiake, për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike si edhe bllokimin e qarkullimit afër zonës ku do të zhvillohet festa në rast se është e nevojshme.

DOKUMENTACIONI DUHET TË JETË ORIGINAL OSE I NJEHSUAR ME

ORIGINALIN

DREJTORE E QAK

ZAMIRA BEQIRAJ (KITA)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

FORMULAR APLIKIMI

PËR MBËSHTETJE TË PJESSHME APO TË PLOTË FINANCIARE

Plotësoni me kujdes këtë formular, sipas të gjitha udhëzimeve, duke i bashkangjitur edhe projektin e detajuar sipas sqarimeve në faqen e fundit.

Data e ardhjes së aplikimit	
1. Titulli i Projektit _____ 2. Fusha e Projektit: Art ☐ Kulturë ☐	Aprovohet po ☐ jo ☐
3. Aplikanti: _____	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

4.Drejtuesi i Projektit: Emri: _____ Mbiemri: _____ Adresa _____ Tel: _____ Adresa e punës: _____ Tel: _____	Shënime																								
5.Zerat e shpenzimeve që kërkohen të mbështeten nga Bashkia <table border="0"><tr><td>5/1:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/2:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/3:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/4:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/5:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/6:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/7:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr><tr><td>5/8:</td><td>shuma</td><td>lekë</td></tr></table>	5/1:	shuma	lekë	5/2:	shuma	lekë	5/3:	shuma	lekë	5/4:	shuma	lekë	5/5:	shuma	lekë	5/6:	shuma	lekë	5/7:	shuma	lekë	5/8:	shuma	lekë	Specialisti Drejtori
5/1:	shuma	lekë																							
5/2:	shuma	lekë																							
5/3:	shuma	lekë																							
5/4:	shuma	lekë																							
5/5:	shuma	lekë																							
5/6:	shuma	lekë																							
5/7:	shuma	lekë																							
5/8:	shuma	lekë																							

6.Donatorë të tjerë të projektit tuaj. Zëri I shpenzimeve të mbuluara. Shuma e dhuruar:

6/1:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

6/2:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

6/3:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

6/4:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

6/5:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

6/6:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

6/7:Donatori _____ zëri I shpenzimeve _____ shuma _____

Buxheti total I projektit tuaj: _____

7.Objekti dhe qëllimi I projektit:

8.Tregoni me saktësi mbështetjen nga Bashkia dy vitet e fundit.

(Projektin, shumën, datën)

8/1:Projekti _____ shuma _____ data _____

8/2:Projekti _____ shuma _____ data _____

8/3:Projekti _____ shuma _____ data _____

8/4:Projekti _____ shuma _____ data _____

8/5:Projekti _____ shuma _____ data _____

8/6:Projekti _____ shuma _____ data _____

9.Bashkëngjitur kësaj Formë-Aplikimi do të paraqisni projektin I cili duhet të jetë hartuar mbi pikat e mëposhtme:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

- Titulli i projektit. Emri i Aplikuesit
- Adresa e plotë e Aplikantit
- Qëllimi i Projektit
- Përshkrimi i Projektit
- Cilësoni përfituesit direkt dhe indirekt të projektit tuaj. Përdorni mundësisht statistika për interesin e publikut ndaj projektit tuaj.
- Përshkruani të renë që sjell projekti juaj në një projekt i ngjashëm me të.
- Ekipi dhe burimet njerëzore: specifikoni emrat, vendin e punës dhe funksionin e secilit pjesëtar të ekipit që do të punojë në këtë projekt.
- Specifikoni burimet dytësore për projektin tuaj në të holla apo shërbime. Si dhe kontratat apo miratimet në parim të të dytëve për ndihmë ndaj projektit tuaj.
- Paraqisni formën juridike të grupimit tuaj.
- Tregoni grafikun kohor të realizimit të projektit tuaj: Fillimi-kohëzgjatje-mbarim
- Ndërtoni dosjen e detajuar të buxhetit të projektit tuaj. Pagesat e sakta të ekipit të këtij projekti si dhe përdorimin e të ardhurave nga ky aktivitet nëse ka të tilla.
- Bashkangjitni projektit dy referenca nga personalitete të fushës së projektit tuaj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

Deklaratë e aplikuesit

Unë, _____

Në cilësinë e aplikantit dhe njëkohësisht të drejtuesit të projektit të paraqitur, deklaroj se të gjitha materialet dhe dokumentacionet e sipërshkruara dhe të bashkangjitura janë të vërteta.

Në rast financimi të këtij projekti pranoj të gjitha kushtet e kontratës që do të lidhet me Bashkinë, për zhvillimin e projektit.

Emri _____ data _____

Nënshkrimi dhe /ose vula e
aplikuesit _____

Kjo formë-aplikimi së bashku me projektin të paraqiten në

PROTOKOLL



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË

Qendra e Artit dhe Kultures Korce

Nr 26/1 Prot.

Datë 18.03.2026

Lënda: Kërkesë për publikim.

BASHKISË KORÇË

SEKTORIT TË PUBLIKIMEVE

Bashkangjitur shkresës po ju dërgojmë dokumentin “Ftesë e hapur për organizimin e aktivitetit “Festa e Birrës” me nr. 26 Prot dt. 18.03.2026, bashkangjitur formularët e aplikimit, i cili duhet të publikohet sot në dt. 18.03.2026 në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

DREJTORE E QAK

Zamira Beqiraj (Kita)

